

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA PODUJEVE, Departamenti i përgjithshëm, divizioni civil si gjykatë e shkallës së parë e përbërë nga gjyqtari Binak Duqi me sekretaren juridike Xhevide Selmani, ne çështjen juridike të paditësit: Sh.Sh. Zh. nga P., rr ”....” pa nr. kundër të paditurit: E. Sh. Zh. nga P., rruga “...” pa nr. baza e kontestit, lirimi i pasurisë se paluajtshme-vërtetim pronësie, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik, në praninë e paditësit dhe të paditurit me dt. 27.03.2014. mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit She.H.Zh. nga P. rr. “...” pa nr. **SI E PABAZUAR**, kundër të paditurit E.Sh.Zh. nga P. rr. “...” pa nr, me të cilin ka kërkuar që “ Vërtetohet se ai është pronar në bazë të aktit të ndërrimit të pasurisë së paluajtshme – ndarjes me axhën e tij R.M.Zh., tani i ndjerë, ish nga P. për ngastrën kadastrave nr. 862-0, në sipërfaqe prej 00.07,63 ha, me kulturë bujqësore, që gjendet në vendin e quajtur “Ledina Mahalla e Breçalivë”, fleta poseduese nr. 573, zona kadastrale P., që evidentohet në emër të R.Z. nga P.”

Obligohet paditësi Sh.Zh. që ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 50 €, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi në padi seanca, dhe fjalën përfundimtare gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se është pronarë i ngastrës - paluejshmërisë nr. 862-0, në sipërfaqe prej 00.07.63 ha, me kulturë bujqësore, që gjendet në vendin e quajtur “Ledina Mahalla e Breçalivë”, e cila evidentohet në fletën poseduese nr. 573 ZK P., në emër të axhës së tij R.M.Xh. tani i ndjerë nga P.

Pronësinë e ka fituar nga axha i tij me aktin e ndarjes së bashkësisë familjare me të pasi që axha ja ka dhënë atij ngastrën kadastrale nr. 862-0, dhe në vend të saj paditësi ia ka dhënë një ngastër tjetër atij.

Padituri E.Sh.Zh. nga P., pa kurrfarë baze ligjore pasurinë kontestuese e ka zaptuar dhe nuk e lejon paditësin që ta posedoi dhe shfrytëzoi, disa herë i ka kërkuar atij ta liroi pronën, mirëpo i padituri nuk ka pranua. Gjatë shqyrtimit kryesor paditësi hoqi dorë nga dëgjimi i dëshmitarit I.Zh. i propozuar nga ai pasi që dëshmitari nuk prezantoi dhe gjykata e aprovoi propozimin e tij me aktvendim në procesverbal. I ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e tij ta aprovoi në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i kërkoi.

Padituri nuk është përgjigjur në padi edhe pse aktvendimi nga gjykata iu ka ekspedituar me dt. 07.06.2013, mirëpo në gjykatë nuk është kthyer fare as fletë kthesa, dhe nuk gjendet dëshmia në shkresat e lëndës.

Në seancën përgatitore, gjatë shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare i padituri ka deklaruar se e kontestoi në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe nuk qëndrojnë fare thëniet e paditësit dhe nuk janë të vërteta. Më tutje ka shtuar se e kam nënën 84 vjeçare dhe e njëjta na ka deklaruar se ne e punojmë atë paluejshmeri që 66 vite dhe e kemi të trashëguar prej babagjyshit tim dhe diku në vitin 1960, ajo tokë ishte e pa punuar dhe për të shkuar në arat tona me i punuar i kalonte rruga mu nëpër atë pronë atëherë babëgjyshi im M. ja ka pagua H. dhe R. kompensimin për këtë pronë. Prej se e mbaj mend unë që 58 vite e kemi punuar rregullisht pronën kontestuese dhe s kemi pasur probleme asnjëherë deri me tani. Por kur paditësi e ka blerë një arë prej B.– M. H. dhe ja ka vnua huajt me e rrethua edhe në arën time bile thellë në te dhe kur e ka marrë kadastrin e ka vërtetuar se nuk është prona në emër të tij por të agjës së tij atëherë kanë filluar problemet ne te në këtë vit. Këtë pronë e kemi blerë prej H.Zh. nga P., rr.”...” ka propozuar si dëshmitare nënën e tij B.Zh. dhe Sh.H.Zh. Mirëpo nëna e tij duke qenë e moshës së shtyrë 84 vjeçare përmes djalit të tij ka sjell në gjykatë një deklaratë me shkrim dhe atëherë i padituri kërkoi që të mos dëgjohet si dëshmitare në gjykatë sepse është e moshës së vjetër dhe gjykata u pajtua me një propozim të tillë, prandaj me aktvendim hoqi dorë nga dëgjimi i kësaj dëshmitareje dhe e pranoi deklaratën e sajë me shkrim të dt. 12.02.2014. në fund ka deklaruar që gjykata të refuzoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar në tërësi sepse nga dëshmitari i dëgjuar dhe deklarata e nënës së tij me shkrim u vërtetua se paditësi nuk ka të drejtë dhe se prona kontestuese më takon mua, andaj kërkoi që gjykata të vendos drejtë dhe në bazë të provave.

Shpenzimet e procedurës i kërkoi.

Gjykata për të vërtetuar drejt gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore në procedurën e provave bëri dëgjimin e dëshmitarit dhe administrimin dhe leximin e këtyre provave. U dëgjua dëshmitari Sh.H.Zh. kushëri i afërtë i palëve ndërgjyqëse kurse mungoi dëshmitari I.Zh. dhe dëshmitarja B.Zh. nëna e të paditurit e cila me deklaratë i u ka drejtuar gjykatës me shkrim, po ashtu u lexua certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme e lëshuar nga zyra kadastrale Komunale Podujevë me nr. *numri i certifikatës* dt. 12.07.2010, kopja e planit e lëshuar nga drejtoria për gjeodezi kadastër dhe pronë Komuna e Podujevës, dt. 12.07.2010, si dhe u lexua deklarata e dëshmitares B.Zh. nga P. të dt. 12.02.2014.

Nga provat e administruara dhe deklarimet e palëve ndërgjyqëse dëshmia e dëshmitarit dhe deklarata e nënës së të paditurit, certifikata mbi të drejtat e pronësisë së paluejshmerisë nr. *numri i certifikatës...*, dt. 12.07.2010, lëshuar nga zyra kadastrave komunale Podujevë, dhe nga kopja e planit e drejtorisë për gjeodezi kadastër dhe pronë Komuna e Podujevës, po ashtu e dt. 12.07.2010, gjykata vërtetoi se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar në tërësi dhe si të tillë e refuzoi si që është cekur në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga dëshmia e dëshmitarit Sh.H.Zh. kushëri i palëve ndërgjyqëse i cili deklaroi në shqyrtim se në këto prona i kemi kullotur dhentë dhe ballicat dhe më pastaj i kemi ndarë, por vetëm kjo pjesa kontestuese ka mbetë e pa ndarë dhe në vitin 1960, kur është

bërë fotografimi i megjave atëherë agja i Sh., babai im H. dhe babai i të paditurit kanë dalë në vend të ngjarjes dhe i kanë vënë gurët e pronës kontestuese dhe kanë mbetur ashtu 2-3 vjet. Babai i të paditurit Sh.Zh. ka deklaruar se lërmani mua këtë pronë ta punojë dhe e ka lëvruar me traktor të kooperativës, por kur lindën problemet Gj.Zh. e këta tre personat e lartpërmendur kanë tentua me u marrë vesh për këtë pronë, atëherë aty Sh. babai i të paditurit ka deklaruar se nuk mundë ta liroi këtë pronë sepse një pjesë të kësaj parcele e ka shitur R.Zh. axha i paditësit e ku në te ishin hisedarë, pjesëtarë, që të tre këta persona të asaj paluejshmërie. Siq ishte babai i të paditurit Sh. axha i paditësit R. me vllaun e vetë H. dhe babai i im H.Zh., sipas tij si që u ka deklaruar Sh. axha i paditësit R. e ka shitur dikund për afërsisht rreth 1 ari e gjysmë të parcelës e cila gjendet në Podujevë. E për këtë unë kam marrë vesh prej babait tim dhe i njëjti më ka deklaruar se nuk e ka marrë asnjë cent nga aji shitje edhe se pse ka qenë pjesëtar i kësaj dhe i ka takua një pjesë e asaj prone. Por është pajtuar me ja lejuar Sh. atë pjesë të pronës kontestuese dhe ja ka bërë për hair por me kusht që aty të mbetet rruga për të kaluar na nëpër te dhe me shkua në arat tona së bashku me R. dhe rruga duhet të jetë 4 metra e gjerë. Me atë rast si që ka deklaruar babai im i kanë ngulur gurët. Me këtë është pajtua edhe vetë R. agja i paditësit dhe që ishte pronarë i një pjese të asaj prone pasi që ai i kishte marrë të hollat nga shitja e një pjese të paluejshmërisë së saj, pra për afërsisht rreth një ari e gjysmë. Këtë ma ka treguar babai im po sa ka ardhur në shtëpi nga vendi i ngjarjes. Me këto fjalë të babait tim jam pajtuar edhe unë edhe për mua kjo çështje ka qenë e përfunduar. Por kur ka shkua në shtëpi R., agja i paditësit Sh. dhe i ka treguar atij se atë pronë ia kanë lënë Sh. e cila është kontestuese sot me kusht që të mbetet rruga 4 metra e gjërë për të kaluar ata dhe me shkua në pronat e tyre atëherë paditësi ka deklaruar agjës së vetë se unë hisen time nuk ia lë dhe ka dalë i ka vënë gurët në pjesën e vetë si që ja ka marrë mendja atij se është e tija. Pas 30 viteve paditësi prej B.- M. e ka blerë një pjesë të një ngastre dhe ka dalë e ka thur me gardh therrash për mos me dalë pulat e tij për me ju bë dem kusherive në pronë. Kur ka ardhur kadastrin kemi vërejtur se pronat tona janë në emër të paraardhësve tanë kurse ajo kontestuese që e kërkon paditësi ishte në emër të agjës së tij R.. Dhe atëherë ky ka deklaruar se kjo pjesë më takon mua.

Nga deklarata me shkrim e dëshmitares B.Zh. nga P. - nëna e të paditurit e cila ka deklaruar se jam e martua te Zh. qe 65 vjet, dhe kur jam martua atë parcelë nuk e ka punuar kurrë paditësi por vjehri im M. e më vonë burri im Sh. dhe djali E. po çuditëm se si ka thënë paditësi Sh. se ajo pronë nuk është punua dhe shfrytëzua kurrë prandaj nga deklarata e nënës së të paditurit gjykata vërteton se kjo pronë nuk është e paditësit dhe ai asnjëherë nuk e ka punuar apo shfrytëzuar atë, se e njëjta nuk është në emër të tij por këtë pronë e ka punua djali E. kurse më parë burri i saj Sh. e para tij vjehri M.

Nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme e lëshuar nga KK, zyra kadastrave Komonale Podujevë me nr. *numri i certifikatës...*, dt. 12.07.2010, gjykata vërtetoi se prona e paluajtshme ngastrave kadastrave 00862-0, në sipërfaqe prej 00.07.63 ha, me kulturë bujqësore, fleta poseduese nr. 573 ZK Podujevë në vendin e quajtur "Ledina –Mahalla e Breclive", është e regjistruar në emër të R.M.Zh. agja i paditësit Sh.Xh. kurse paditësi nuk është pronarë i kësaj paluejshmërie.

Nga prova kopja e planit lëshuar nga drejtoria për gjeodezi pronë dhe kadastrë dt. 12.07.2010, gjykata vërtetoi se pronarë i ngastrës nr. 862-0, në vendin e quajtur Mahalla e Breclive në sipërfaqe prej 00.07.63 ha, është R.M.Zh. agja i paditësit në fletën poseduese 573.

Prandaj nisur nga një gjendje e tillë vërtetuar në procedurë nga provat materiale, deklarimi i palëve ndërgjyqëse, dëshmia e dëshmitarit Sh.H.Zh. dhe deklarata e B.Zh. gjykata vërtetoi se padituri e punon pronën dhe paditësi asnjëherë nuk e ka punuar as shfrytëzuar atë, se kjo ngastër kadastrave është e regjistruar në emër të R.M.Zh. agja i paditësit Sh.H.Zh., se paditësi asnjëherë dhe me asnjë provë nuk e vërtetoi se vërtetë ka bërë ndërrim pronash me agjën e tij duke deklaruar se e ka marrë pronën nr. 862 nga agja i tij por nuk përmend se çfarë ngastre dhe cilin nr. të sajë i ka dhënë si kompensim agjës së vet. Prandaj bien poshtë pretendimet e tija si të pabazuara.

Kjo pronë kur janë ndarë palët ndërgjyqëse – paraardhësit e tyre Sh., R. agja i paditësit dhe babai i dëshmitarit Sh.Zh.- H., ata janë pajtuar që kjo ngastër që është kontestuese ti mbetet babait të paditurit Sh. me kusht që ky ta lejojë nëpër atë ngastër rrugën e gjerë 4 metra për të shkuar R. dhe H. në pronat e tyre pa pengesa me i punua pronat e tyre.

Se agja i paditësit R. e kishte shitur një pjesë të pronës nga kjo ngastër gjegjësisht një ari e gjysmë dhe të hollat i ka marrë vetëm ai andaj mu kjo është arsyeja që R. është pajtuar me ia lënë babait të paditurit këtë pjesën tjetër e ku është pajtuar dhe H. babai i dëshmitarit dhe po atë ditë i kanë vënë gurët e mezhdave ku përpos Sh., H. dhe R. aty ka qenë edhe Gj. Zh. i cili ka vdekë. Prandaj gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar në tërësi si që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi sepse me prova materiale në procedurë nuk u vërtetua si e bazuar kërkesëpadia e tij.

Gjykata i fali besimin deklarimit të paditurit, dëshmisë së dëshmitarit Sh. Zh. dhe deklaratës së dëshmitares B.Zh. si objektive dhe të bazuara e të mbështetura me prova tjera si certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme dhe kopja e planit të lëshuar nga drejtoria për gjeodezi pronë dhe kadastrë.

Gjykata nuk i besoi dhe nuk i fali besimin deklarimit të paditësit Sh.Zh. kur në padi deklaroi por edhe gjatë seancave se gjëja kur është ndarë prej agjës së tij dhe kur e kanë ndarë bashkësinë familjare prej R. e ka fituar këtë pronë dhe është bërë pronarë i sajë duke bërë ndërrimin e një ngastre që ja ka dhënë agjës së tij R. por pa specifikuar fare cilën ngastër dhe me cilin numër ja ka dhënë dhe ka marrë nga ai ngastrën kadastrale 862-0, sepse këto thënie të tija nuk u vërtetuan me prova në procedurë në asnjë mënyrë.

Meqenëse paditësi nuk është pronarë dhe i njëjti nuk vërtetoi me prova ta ketë fituar pronësinë mbi atë paluejshmëri gjithashtu edhe provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës nuk e dëshmojnë atë se ai ka të drejtë, se ai të jetë pronarë i ngastrës mirëpo pronari i tij ka qenë agja R. atëherë nga provat u vërtetua se atë pronë e punon dhe e shfrytëzon i padituri e jo paditësi e këtë e në bazë të marrëveshjes gojore kur e kanë ndarë bashkësinë familjare H.Xh., Sh.Zh. dhe R.Zh. E ku ishte prezent edhe Gj. Zh. se ata i kanë vënë gurët e mezhdave, se atë pronë ja kanë lënë Sh. me kushtin që ky të lejojë rrugën 4 metra të gjëra pa i penguar H. dhe R. me kaluar nëpër te e me shkua në pronën e tyre. Tërë kjo pa dyshim u vërtetua nga padituri deklarata e nënës së tij B.Zh., dëshmitarit Sh.Zh. si dhe provat tjera materiale që gjenden në shkresat e lëndës. Prandaj gjykata vendosi që ta refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi. Gjithashtu duke pas parasysh ligjin mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr. 03/L-154 në nenet 18, 36, 40, si dhe në nenet 7, 20, 28.4.5 dhe 33 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridiko pronësore në këtë rast në asnjë prej këtyre neneve nuk plotësohen kushtet që paditësi të ketë të drejtë dhe ta ketë fituar pronësinë prandaj, gjykatës nuk i

mbeti tjetër pos që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pabazuar si që është e cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 50 € me të cilën u obligua paditësi që ato ti bartë konformë nenit 449.1.452.1 dhe 453.1 të LPK këtë shumë në emër të taksë gjyqësore për padi dhe aktgjykim.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE- DEGA PODUJEVE
C.nr.389/10 të dt. 27.03.2014.

Gjyqtari:
Binak Duqi

KESHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar
Ankesa në afatin prej 15 ditësh, prej ditës
Së marrjes së këtij Gjykatës së Apelit
Prishtinë përmes kësaj gjykate.